


UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

Studime postdiplomatike -Master



TEZA MASTER

Ndikimi i teknikave ndërvepruese në përvetësimin e Gjuhës shqipe në shkollën e mesme të ulët (6-9)

Mentori:

Prof. Dr. Naser Zabeli

Kandidatja:

Makfire Bërbatovci-Hyseni

Prishtinë, 2022

FAKULTETI I EDUKIMIT

Studimet Master

PROGRAMI: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

TEZA MASTER

E paraqitur nga:

Makfire Bërbatovci-Hyseni

Me kërkim të gradës shkencore

Master

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli

Tema: Ndikimi i teknikave ndërvepruese në përvetësimin e Gjuhës shqipe në shkollën e mesme të ulët (6-9)

Mbrohet para komisionit vlerësues të përbërë nga:

Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli_____mentor

Prof. Asoc. Dr. Xhavit Beqiri_____ kryetar

Prof. Ass. Dr. Vjollca Ahmedi_____ anëtare

Prishtinë, Mars 2022

©2022-*Makfire Bërbatovci Hyseni*, Të gjitha të drejtat të rezervuara

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të shqyrtohet ndikimi i teknikave mësimore të mësimdhënies, në favor të një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më efikase. Nëse në shoqërinë tonë ka profesione që janë me përgjegjësi, atëherë njëri prej këtyre profesioneve është ai i mësimdhënies. Mësimdhënia është një proces në ndryshim të vazhdueshëm që reflektohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor.

Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton të nxënit aktiv, të menduarit në mënyrë kritike, krijuese dhe të nxënit me nxënësin në qendër.

Projekti për zhvillimin e Mendimit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit është një projekt bashkëpunimi në mes mësimdhënësve dhe nxënësve që ka për qëllim të sjellë në klasë metoda mësimore ,të cilat nxitin zhvillimin e mendimit kritik mes nxënësve të të gjitha moshave dhe në përgjithësi në të gjitha lëndët dhe në veçanti në lëndën e gjuhës shqipe(KEC, 1998).Mendimi kritik na sjell një numër të madh teknikash që zbatohen në orën mësimore.

Ky studim është projektuar për të shqyrtuar se sa ndikojnë teknikat ndërvepruese të mësimdhënies nga ana e mësimdhënësve gjatë planifikimit të mësimdhënies dhe efektet e tyre në përvetësimin e gjuhës shqipe.

Qasja që është përdorur në këtë hulumtim është qasja sasiore. Mostër e përcaktuar në këtë hulumtim ishin katër shkolla të komunës së Vushtrrisë . Pjesëmarrës të këtij hulumtimi ishin 150 nxënës dhe 30 mësimdhënës të lëndës së gjuhës shqipe. Instrumentet të cilat u përdorën për mbledhjen e të dhënave ishin pyetësorët. Një pyetësor ishte i formuluar për mësimdhënësit dhe një tjetër pyetësor për nxënësit. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se ndikimi i teknikave ndërvepruese ndikon konsiderueshëm në ngritjen e rezultateve të të nxënit të nxënësve në lëndë e gjuhë shqipe.

Fjalët kyçe: Teknikat ndërvepruese, metodat, mësimdhënia, nxënësi, mendimi kritik.

Abstract

The main purpose of this paper is to examine the use of teaching techniques, in favor of a more efficient teaching and learning. In our society there are professions that require great responsibility such as teaching. Teaching is an ever-changing process that is reflected in improving the quality of the educational service.

Contemporary teaching means active learning, critical thinking, creative and student-centered learning.

The project for the development of critical thinking during reading and writing is a collaborative project between teachers and students that aims to bring to class teaching methods, which promote the development of critical thinking among students of all ages and in general in all subjects, especially in that of Albanian language. (KEC, 1998). Critical thinking brings us a large number of techniques that are applied in the classroom.

This study is designed to examine the extent to which interactive teaching techniques are applied by teachers during teaching planning and their effects on the subject of Albanian Language.

The approach used in this research is the quantitative one. My research is based on four schools of the Municipality of Vushtrri. 150 students and 30 Albanian language teachers were participants in this research. The instruments that were used for data collection were questionnaires. One questionnaire was formulated for teachers and another questionnaire for students.

Keywords: Interactive techniques, methods, teaching, student, critical thinking.

FALËNDERIM

Me shumë kënaqësi do të doja të shprehja falënderimet e mia të sinqerta së pari për familjen time, për përkrahjen në çdo hap të këtij rrugëtimi tim deri në ditën e sotme. Falënderim i sinqertë për të gjithë ata që më ndihmuan, konsultuan dhe më mbështetën gjatë realizimit të kësaj teme.

Falënderoj anëtarët e komisionit në përbërje më prof. dr. Xhavit Beqiri, prof.dr. Vjollca Ahmedi, e në mënyrë të veçantë falënderim dhe mirënjohje për mentorin tim në këtë temë prof. dr. Naser Pajazitin ,për besimin që pati tek unë, për këshillat e tij, mbështetjen, përkushtimin dhe durimin që tregoi gjatë gjithë kohës se kemi punuar në përfundimin e kësaj teme masteri.

Përmbajtja

Abstrakt	i
Abstract	ii
<i>FALËNDERIM</i>	iii
HYRJE.....	1
1.1.QËLLIMI I HULUMTIMIT	2
1.2.PYETJA E HULUMTIMIT.....	3
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS	4
2.1. Mësimdhënia bashkëkohore e gjuhës shqipe.....	6
2.2.Rëndësia e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët.....	7
2.3.Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” dhe lënda e gjuhës shqipe.....	7
2.4.Metodologjia për zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe	8
3.Teknikat mësimore në mësimin e gjuhës.....	8
3.1.Teknikat mësimore që e bëjnë mësimin më efikas	10
3.2.Llojet e teknikave ndërvepruese në përvetësimin e gjuhës	12
3.2.2.Mendo/puno në dyshe/shkëmbe me të tjerët.....	13
3.2.3.Ruaje fjalën e fundit për mua.....	13
3.2.4. Kllasteri	14
3.2.6.Pesëvargëshi.....	15
3.2.7.Ese 5-10 dhe shkrime të lira.....	16
3.2.8.DRTA.....	16
3.2.9.Di / dua të di /mësova	17
3.2.10.Rrjeti i diskutimit	17
3.2.11.Diagrami i Venit.....	18
3.2.12.Teknika e diskutimit.....	19
3.3.Rëndësia eteknikave në mësimdhënien e gjuhës	20
4.1.Metodat mësimore dhe rëndësia e tyre	21
4.1.1.Metoda e dialogut(bashkëbiseduese)	23
4.1.2.Metoda e diskutimit	24
4.1.3.Metoda e demonstrimit	25
4.1.4.Metoda e punës me tekst.....	25

4.1.5. Metoda e aktivitetit praktik	25
4.1.6. Metoda e parashtrimit	26
5. Format e organizimit të punës mësimore.....	27
5.1. Puna mësimore në formë të organizimit frontal-kolektiv (ballor).....	27
5.1.1. Format e punës mësimore në grupe	28
5.1.2. Forma e punës mësimore në çifte	29
5.1.3. Forma e organizimit të punës në mënyrë individuale	30
5.2. Mendimi kritik	30
3.4. Përparsitë e strukture ERR	34
III. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	36
IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET	38
4.1 Rezultatet e fituara nga pyetësorët me mësimdhënësit e katër shkollave të Vushtrrisë ...	41
V. DISKUTIMET DHE KONKLUDIMET	96
Konkludime	97
REFERENCA BIBLIOGRAFIKE	99
SHTOJCA A.....	102
PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS	102

Lista e tabelave

Në tabelën 1 është paraqitur ndarja e mësimdhënësve sipas moshës.....	38
Në tabelën 2 është paraqitur ndarja e mësimdhënësve sipas gjinisë.	39
Në tabelën 3 është paraqitur ndarja e mësimdhënësve sipas përgatitjes profesionale	40
Tabela .4. .A keni ndjekur trajnimin e Mendimit kritik, ose ndonjë trajnim tjetër lidhur me teknikat ndërvepruese të mësimdhënies.	41
Tabela Nr.5. Mësimnxënia e gjuhës shqipe duke zbatuar teknikat ndërvepruese.....	44
Tabela.6.Teknikat ndërvepruese në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies në lëndën e gjuhës shqipe.....	46
Tabela.7. Sa janë të vlefshme teknikat ndërvepruese që ju përdorni gjatë orës mësimore në lëndën gjuhës shqipe?	48
Tabela 8. Përdorimi i teknikave mësimore që nxisin te nxënësit të menduarit kritik në gjuhë shqipe.....	50
Tabela 9. Teknikat e mësimdhënies që praktikohen më shpesh në lëndën e gjuhës shqipe.	52
Tabela.10. Përdorimi i teknikave mësimore në lehtësimin e të shkruarit dhe të lexuarit?.....	55
Tabela 10. Përdorimi i teknikave mësimore në lehtësimin e të mësuarit dhe të kuptuarit e gjuhës shqipe?.....	57
Tabela 11. Përdorimi i teknikave që nxënësit e përvetësojnë gjuhës më shpejtë dhe më lehtë .59	
Tabela 12. Teknikat më frytdhënëse për mësimin e gjuhës nxënësve.	61
Tabela 13 Metodrat që i përdorin më shpesh mësimdhënësit për mësimin e gjuhës shqipe me nxënës.....	63
Tabela Nr.14. Praktikimi i formave të punës gjatë orës mësimore të gjuhës shqipe.	65
Tabela.15. Ndryshimi i orës mësimore duke përdorur metodat dhe teknika mësimore.....	68
Tabela 16. Qendër mësuesi dhe Qendër nxënësi	71
Tabela. 17. Në pyetjen A keni njohuri të mjaftueshme për teknikat ndërvepruese të mësimdhënies në lëndën e gjuhës shqipe ?	75

Tabela 18. A ju pëlqejnë metodat teknikat dhe format e punës që përdorin mësime dhënësit tuaj për mësimin e gjuhës shqipe?.....	76
Tabela.19.Përdorimi i teknikave mësimore në procesin e mësimdhënies ndikon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies?	78
Tabela.20. Çka ju pëlqen më së shumti në lëndën e gjuhës shqipe?.....	80
Tabela. 21. Sa ua lehtësojnë të shkruarit dhe të lexuarit përdorimi i teknikave mësimore në lëndën e gjuhës shqipe?.....	82
Tabela.22. Sa ua lehtësojnë të mësuarit dhe të kuptuarit nxënësve përdorimi i teknikave mësimore në lëndën e gjuhës shqipe?	84
Tabela. 23. Të menduarit kritik zhvillohet përmes aplikimit të teknikave mësimore	86
Tabela 24. Cilat nga metodat e propozuar më poshtë ju pëlqejnë më shumë juve për të mësuar gjuhën shqipe më lehtë, më mire dhe më shpejtë në klasë?	88
Tabela.25.Të nxënit në lëndën e gjuhës shqipe e përvetësoni më lehtë përmes pjesëmarrjes në diskutime?	91
Tabela 26.Cilat teknika përdorin mësime dhënësit në lëndën e gjuhës shqipe?	94

Lista e Grafikut

Grafiku.1.Trajnimet e mësimdhënësve lidhur me teknikat ndërvepruese	43
Grafiku.2. Zbatimi i teknikave në mësimnxënie më të lehtë në lëndën e gjuhës shqipe?.....	45
Grafiku.3.Sa mund të ndikojë përdorimi i teknikave ndërvepruese në ngritjen e cilësisë së mësimdhënësit në lëndën e gjuhës shqipe?	47
Grafikoni.4. .A janë të vlefshme teknikat mësimore që ju përdorni gjatë orës së gjuhës shqipe	49
Diagrami Nr.5.Teknikat që nxisin mendimin kritik te nxënësit në gjuhë shqipe.....	51
Grafiku.6.Teknikat e mësimdhënies që praktikohen më shpesh në lëndën e gjuhës shqipe.	54
Grafiku. 7. Përdorimi i teknikave mësimore në lehtësimin e të shkruarit dhe të lexuarit?	56
Grafiku. 8. Përdorimi i teknikave mësimore në lehtësimin e të mësuarit dhe të kuptuarit?	58
Grafikoni 9.Teknikat që nxitin nxënësit ta përvetësojnë gjuhës më shpejtë dhe më lehtë.....	60
Grafikoni 10. Teknika më frytdhënëse për mësimin e gjuhës	62
Grafikoni.11Metodat që përdorën më shpesh në klasë nga mësimdhënësit për mësimin e gjuhës.	64
Grafiku 12. Format e punës i që praktikojnë mësimdhënësit më shumë me nxënës për mësimin e gjuhës shqipe.	67
Grafiku.13.A vini re ndryshime në realizimin e orës mësimore duke përdorur metodat dhe teknikat mësimore të mësimdhënies?.....	70
Grafiku.14. Qendër mësuesi dhe Qendër nxënësi	72

HYRJE

Me kalimin e dekadave në arsimin shqiptar parauniversitar metodologjitë dhe teknikat në procesin e mësimdhënies-mësimnxënies, kanë pësuar ndryshime të shumta. Mësimdhënia bashkëkohore kërkon planifikim të mirëfilltë të materialit mësimor, metodologjisë mësimore dhe teknikave që do të përdoren për të arritur objektivat mësimor dhe synimet e shoqërisë. Procesi i mësimdhënies dhe të nxënies në mësim është një proces sa kompleks aq edhe sfidues. Ky punim i ka për qëllim të ofrojë informata rrethë teknikave ndërvepruese të mësimdhënies, sa përdoren ato nga mësimdhënësit, dhe rezultatet që arrihen me përdorimin e tyre gjatë procesit mësimor.

Mësimdhënia bashkëkohore lejon që nxënësit të marrin pjesë në një shumëllojshmëri aktivitetesh, ku ata mund të mësojnë nga njëri-tjetri, mund të diskutojnë e ndajë idetë e tyre, dhe të punojnë në çifte apo grupe të vogla. Mësimdhënia me në qendër me nxënësin është shndërruar në një lëvizje të gjerë me synim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mësimdhënia bashkëkohore me në qendër nxënësin kërkon përdorimin e teknikave mësimore, të cilat nxisin të menduarit kritik dhe krijues të nxënësve.

Shkolla sot është një institucion që synon të përgatit gjeneratat e reja për të kërkuar informacionin, për të operuar dhe analizuar në mënyrë kritike si dhe për të aftësuar nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin probleme në mënyrë kritik.(Musai, 2003, p. 12). Mësimdhënia përmes përdorimit në klasë të strategjive, metodave dhe teknikave të mësimdhënies, po i japin përmasa të reja mësimi, duke nxitur mendimin kritik dhe të nxënies e pavarur.

Detyrë e mësimdhënësve bashkëkohorë do të jetë të sigurojnë plan mësimor i cili parasheh përdorimin e teknikave ndërvepruese në mënyrë që çdo nxënës të mund të marr pjesë në procesin mësimor. Mësimdhënia e bazuar në filozofinë e zhvillimit të mendimit kritik gjatë të lexuarit ose të shkruarit, e cila bazohet në strukturën(ERR) ,Evokim, Realizim i kuptimit dhe Reflektim.

Ky punim i kushtohet metodave, teknikave, formave dhe mjeteve mësimore me në qendër nxënësin duke u nisur nga fakti se përdorimi i teknikave të ndryshme në mësimdhënie është shumë i rëndësishëm në mënyrën sesi nxënësi nxënë. Puna e përditshme si mësimdhënës kërkon njohje dhe zbatim të teknikave: Brainstorming (stuhi mendimesh), kllaster, di/dua të di, mësoj, diagrami i venit, ditari dypjesësh, shkrim i lire, parashikimi i termave paraprak, insert etj, në procesin e mësimdhënies, të cilat luajnë rol kyç për suksesin e gjithëmbarshtëm të nxënësve.

Të njohësh metodat dhe teknikat e mësimit është njëra anë e medaljes por t'i zbatosh ato në mënyrë permanente është shpeshherë jo e lehtë. Mendoj se për një mësimit është shumë e rëndësishme përzgjedhja dhe përdorimi i metodave dhe teknikave që do të përdorë mësimit. Metodat dhe teknikat e mësimit kanë rëndësi të veçantë dhe kanë për qëllim që t'u mësojmë nxënësve shprehjet e të nxënësve afatgjatë, dhe zhvillon të menduarit kritik. Ndikim të madh ka zbatimi i teknikave ndërruese në mënyrën sesi nxënësit e kuptojnë informacionin, në zgjedhjen e problemeve. Teknikat ndërruese është mirë të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësimit, në përputhje me karakterin e dijeve, të objektivave lëndore si dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimit dhe nxënësit.

Me fjalën teknikë kuptojmë tërësinë e mjeteve të ndryshme që mësimit dhe nxënësi e zbatojnë në procesin mësimit, si dhe përmbajtjen, metodat dhe komponentët e tjerë mësimit.

Para mësimit sot shtrohet kërkesa që ai t'u përgjigjet strukturës dhe përmbajtjes së kurrikulës së re me më shumë strategji gjithëpërfshirëse. Kjo mund të arrihet me realizimin e formave të ndryshme të punës mësimit (puna në çifte, puna në grupe, puna individuale) dhe modeleve të ndryshme të mësimit, të cilat vendosin në qendër të vëmendjes nxënësin, (Sylejmani, 2014, p. 40).

1.1.QËLLIMI I HULUMTIMIT

Në këtë punim ne trajtuam çështjen e teknikave ndërruese që po aplikohen gjerësisht në mësimit e gjuhës shqipe. Ky punim fokusohet tek teknikat dhe metodat me në qendër nxënësin duke u nisur nga fakti se: se përdorimi i teknikave dhe metodave të ndryshme në mësimit e gjuhës është shumë i rëndësishëm në mënyrën sesi nxënësi nxë. Shtysë për realizimin e kësaj teme ka shërbyer interesi im për përdorimin e këtyre teknikave në mësimit që do të zhvilloj në vitet në vijim, në funksion të mësimit efektive dhe shoqërimit të nxënësve.

1.2.PYETJA E HULUMTIMIT

- 1.Sa mund të ndikojë përdorimi i teknikave ndërvepruese në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në lëndën e gjuhës shqipe?
- 2.Cilat teknika ndikojnë më shumë ne të menduarit kritik?
3. Çka përfitojnë nxënësit përmes këtyre teknikave?

HIPOTEZAT E NGRITURA

1. Përdorimi i teknikave mësimore në procesin e mësimdhënies ndikon dukshëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe motivon nxënësit për mësimnxënie të pavarur .
2. Për të nxitur të menduarit, mësimdhënësi zbaton teknika të ndryshme ndërvepruese në klasë.
3. Këto teknika kanë treguar se nxënësi është epiqendra e orës, duke nxitur tek ata aftësitë krijuese dhe kritike, duke i bërë të gjithëpërfshihen në procesin mësimor.

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Zhvillimet e vrullshme në shoqërinë e sotme paraqesin një sfidë për ata (mësimdhënësit) që përgatisin nxënësit e shekullit XXI. Të gjitha metodat, teknikat dhe strategjitë në metodologjinë e zhvillimit të mendimit kritik gjatë leximit dhe shkrimit bëjnë pjesë në metodologjinë ndërvepruese. (Hyseni&Nikoleta&Salihaj&Popovci, 2003). (Grillo, 2002) shpjegon se mësimdhënia “është faktor kryesor në realizimin e mësimnxënies; është akti i të dhënit mësim në një institucion arsimor; është veprimtaria dhe drejtimi i procesit mësimor nga mësuesi” (p,182).

(Gjokutaj, 2005) thekson se: “Mësimdhënia bashkëkohore e gjuhës shqipe është proces i të nxënësve aktiv, i të menduarit kritik-krijues, proces i nxënies së dijes me në qendër nxënësin”.(p.16).(Nëse mësojmë nxënësin për të menduar në mënyrë kritike, atëherë kjo duhet të bëhet vazhdimisht në praktikën e mësimdhënies.(Zelina, 1994, p. 162).

Në mësimdhënien bashkëkohore përdoren strategji të ndryshme, por asnjëra nuk mund të jetë e përshtatshme për të gjithë nxënësit dhe të arrihen suksese të larta. Prandaj është e nevojshme të përzgjedhjen strategji të mësimdhënies dhe t’iu përshtaten nevojave e dallimeve në mes nxënësve të ndryshëm.(Fullan, 2001).

Gardner vë në dukje se” Sipas një përkufizimi, mësimdhënës i aftë është ai që, për të njëjtin koncept, mund të hap një numër dritarësh... Një mësimdhënës i suksesshëm shërben si një “ndërmjetës midis nxënësit dhe programit mësimor”.(Gardner, 2003, p. 214).

Çdo mësimdhënës përpiqet për të ndikuar në ngritjen e efikasitetit në mësim. Detyra kryesore e mësimdhënësit është të ndërtojë veprimtari mësimore, të cilat të përmbushin arritjen e rezultateve të nxënësve që parashikohen në objektiva. Në fillim të mësimit është e nevojshme që mësuesi të ketë ide se ç’lloj i të nxënësve është i përshtatshëm për nxënësit e tij dhe pastaj, si ta zhvillojë mësimin, që të lehtësojë të nxënësve.(Musai, 2003, p. 80).Mësimdhënësi ndryshon mënyrën e: mësimdhënies, planifikimit, menaxhimit të klasës, zbatimit të metodave mësimore.

Ndërsa te nxënësi vërejmë këto ndryshime: aftësinë për të menduar në mënyrë kritike, përpjekja për të dhënë përfundime logjike, dëshira për të parashtruar pyetje, bashkëveprim në klasë, rritja e interesimit për të dhënë ide të reja .(Ismajli, 2012, p. 85).

Nocioni “teknikë” ka prejardhjen të lashtë. Fjala “techne” rrjedh nga gjuha greke, që do të thotë shkathtësi, mjeshtëri, aftësi, mënyrë, veprim, rrjedhe e punës(Bratoljub, 1970). Fjalën teknikë kuptojmë tërësinë e mjeteve të ndryshme që mësimdhënësi dhe nxënësi e zbatojnë në procesin mësimor, si dhe përmbajtjen, metodat dhe komponentët e tjerë mësimorë.(Zylfiu, 2001, p. 204) Sipas ”Fjalorit enciklopedik të pedagogjisë, (1963) nocioni teknikë ”ka lindur nën ndikimin e zhvillimit intensiv të teknikës dhe bazohet në shkathtësitë praktike të mësimdhënësit në realizimin e mësimor, p.sh . teknikën e organizimit të punës së nxënësit në situata të ndryshme mësimore. (p. 840).Pedagogët e tjerë me nocionin ”teknikë” nënkuptojnë teknikat e mësimdhënies, metodat, veprimet dhe format e punës mësimore. Sipas(Predanoviq & Niçkoviç, 1982) “me nocionin teknikë arsimore sot kryesisht e kuptojmë tërësinë e mjeteve të ndryshme që mësimdhënësi dhe nxënësi i zbatojnë në procesin mësimor”.(p. 62).Me nocionin teknikë mësimore nënkuptojmë përfshirjen e të gjitha mjeteve bashkëkohore, përdorimin e tyre si dhe veprimtarit që realizohen gjatë punës mësimore.(Zylfiu, 2001, p. 204). Në Fjalorin e pedagogjisë, thekson se “rrugët në kuptimin e fjalës teknikë mësimore, nënkuptojmë zbatimin me përpikëri dhe në mënyrë krijuese të metodave dhe të formave të punës, nga ana e mësimdhënësit”.(Osmani, 1983, p. 674).

Në fjalorin e gjuhës shqipe theksohet se teknika mësimore paraqet “tërësinë e mënyrave dhe metodave që përdoren në një punë të caktuar dhe shkalla e zotërimit të këtyre mënyrave dhe metodave”.(Fjalor i shqipes së sotme, 2002, p. 1329).Në mbështetje të përkufizimeve të lartpërmendura, përfundojmë se nocioni teknikë nënkupton tërësinë e të gjitha mjeteve mësimore, makinave e instrumenteve të cilat mësimdhënësi dhe nxënësi i përdorin me qëllim të modernizimit të procesit mësimor. Teknika mësimore duke integruar një numër të konsiderueshëm të mjeteve mësimore ka për qëllim të zgjerojë dhe të thellojë njohurit tek nxënësi, kuptimi i nocionit teknikë arsimore, ka dëmthënie komplekse, sepse çdo teknikë sot luan rolin e ndërmjetësuesit në mes teorisë dhe praktikës mësimore.(Ismajli, 2012, p. 26).

2.1. Mësimdhënia bashkëkohore e gjuhës shqipe

Mësimdhënia është më shumë sesa punë. Ajo është ndër përgjegjësitë më të mëdha të shoqërive të civilizuar. Në artin e mësimdhënies, mësimdhënësi nxit shkëndijat e mendjes së nxënësve dhe kështu ua ushtron mendjen për të pyetur, hulumtuar, zbuluar, etj. Roli i mësimdhënësit është që të bartë njohuritë e tij te gjeneratat e ardhme për të mos humbur apo për të mos mbetur në harresë. Kur themi se mësimdhënia është art, atëherë duhet ta dimë se ajo kërkon kreativitet, ndjeshmëri dhe inteligjencë.(MASHT, Revista Mësuesi, 2014). Mësimdhënia është një proces jo i lehtë, është veprimtari e rëndësishme shoqërore dhe me përgjegjësi. Ka mendime se mësimdhënia është art, është shkencë, apo të dyja së bashku. "Nëse është mësimdhënia art, kërkon frymëzim, intuitë, talent e krijimtari dhe pak prej tyre mund të mësohen". (Musai, 1999, p. 19). "Nëse është shkencë, mësimdhënia kërkon njohuri dhe shprehi që me të vërtetë të mësohen". Ne mund të shprehin mendimin tonë se mësimdhënia e suksesshme ka këto dy anë." Mësimdhënia e mire ka brenda elemente të punës së artistit dhe studiuesit". (Musai, 1999, p. 21).

Mësimdhënia më e mire është ajo gjatë së cilës përmbushen objektivat, aktivizohen nxënësit, nxitet ndërveprimi, përdoren pyetje të niveleve të larta, ku nxënësi është në qendër të mësimdhënies, zhvillohen aftësitë, të menduarit kritik e krijues, bëhet reflektimi dhe nxënësi aftësohet për të punuar në mënyrë të pavarur. Vet emërtimi mësimdhënie bashkëkohore nënkupton një mësimdhënie ndryshe nga ajo tradicionale". Mësimdhënia bashkëkohore nënkuptohet në shumë aspekte si; në strategji, metoda, teknika, forma, ndryshimin e rolit të mësimdhënësit dhe nxënësit, mjedisin shkollor, në respektimin e të drejtave të fëmijëve, në të kuptuarit dhe të menduarit ndryshe, në përcaktimin e objektivave, në vlerësim etj."(Grup autorësh, 2005, p. 16).

Mësimdhënia bashkëkohore mbështetet në disa parime:

- ❖ Aftëson nxënësit për të nxënë e pavarur
- ❖ Nxit nxënësit që të jenë nismëtar,
- ❖ Krijohet dallueshmëri në të nxënë dhe nxitet të menduarit kritik, krijues.
- ❖ Nxit dhe krijon kushte për komunikim shumëkahor dhe të frytshëm.
- ❖ Aftëson nxënësit për vlerësim dhe vetëvlerësim.

2.2.Rëndësia e lëndës së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët

Gjuha shqipe është lënda kryesore që ndikon në zhvillimin intelektual, shoqëror, estetik dhe emocional të nxënësve. Ajo i pajis nxënësit me njohuri, aftësi, vlera dhe qëndrime, të cilat janë përcaktuese jo vetëm për arritjet e tyre në çdo fushë dhe lëndë mësimore, por edhe për të qenë të suksesshëm në botën përtej shkollës. Duke qenë kaq të rëndësishme në jetën njerëzore, gjuha shqipe është trajtuar si e tillë edhe në kurrikulën e shkollës. Në procesin e zbatimit të programeve të reja janë të nevojshme mbështetja dhe udhëzimet e vazhdueshme për mësimdhënësit. Pjesë e kësaj mbështetjeje është edhe hartimi i udhëzuesit lëndor për mësuesit e gjuhës shqipe të arsimit të mesëm të ulët (klasat 6-9).(IZHA, 2014, p. 4)

Në lëndën e gjuhës shqipe, nxënësit fitojnë njohuri, aftësi, shkathtësi, vlera dhe qëndrime për të komunikuar me gojë dhe me shkrim; lexojnë dhe kuptojnë tekste të llojeve të ndryshme; pasurojnë fjalorin dhe botëkuptimin e tyre duke lexuar tekste letrare dhe joletrare; mësojnë të shkruajnë tekste të ndryshme (opinionë, raporte, udhëzime etj.); mësojnë ta përdorin drejt nga ana gramatikore dhe drejtshkrimore gjuhën etj. Të gjitha këto njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime sigurojnë suksesin e nxënësve edhe në fushat dhe lëndët e tjera.(IZHA, 2014, p. 14)

2.3.Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” dhe lënda e gjuhës shqipe

Lënda e gjuhës shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”.Kjo fushë i aftëson nxënësit që të përdorin saktë gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interes e tyre personale, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës.Mësimi i gjuhës shqipe zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal e kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhën e kulturën kombëtare dhe ato botërore. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, horigjinalë dhe krijues.

Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe të qëllimit që kanë.

Arritjet gjuhësore të nxënësve janë përcaktuese jo vetëm për lëndët e fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, por dhe për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë mirë, ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, fusha dhe lëndët që e përbëjnë atë, janë një nga detyrat parësore të arsimit bazë.(IZHA, 2014, p. 6).

2.4. Metodologjia për zhvillimin e lëndës së gjuhës shqipe

Strategjitë, metodat dhe teknikat e mësimdhënies përfaqësojnë procedura standarde didaktike, të cilat përdoren nga ana e mësuesve në bashkëpunim me nxënësit për prezantimin dhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore, me qëllim përmbushjen e rezultateve të të nxënësve. Mësimdhënia bashkëkohore dikton përdorimin e metodave dhe të teknikave, të cilat synojnë jo thjesht dhënien e njohurive, por aftësimin e nxënësve për të përballuar sfidat e jetës e për të marrë pjesë suksesshëm në jetën personale dhe profesionale. Mësimdhënësit nga natyra janë krijuar në procesin mësimor. Dashuria dhe pasioni për punën i bën ata të jenë vazhdimisht në kërkim të zhvillimit të tyre profesional. Mirëpo shpesh ndodh që megjithëse disa metoda dhe teknika, teksa i dëgjojnë në trajnime dhe seminare janë interesante, kur i zbatojnë në klasë hasin jo rrallë herë vështirësi. Për këtë arsye duhet që mësimdhënësit të ndërgjegjësohen që: Më e rëndësishme është ajo që mësohet dhe jo metoda që përdoret. Pra, metodat dhe teknikat duhet të përshtaten me natyrën e lëndës dhe qëllimet e të nxënësve. (IZHA, 2018, p. 16).

3. Teknikat mësimore në mësimin e gjuhës

Duke pasur parasysh ndryshimet e mëdha, të cilat po bëhen viteve të fundit në shkencë dhe teknikë, është bërë nevojë përdorimi i strategjive të reja mësimore dhe realizimin e kërkesave praktike, të cilat synojnë ndryshimin e qëllimeve, teknikave, objektivave, metodave, formave dhe mjeteve të punës në shkollë. Çështjen e përdorimit të teknikave mësimore e kanë diskutuar shumë pedagogë e psikologë të mëdhenj të kohërave të ndryshme, duke filluar që nga (Sokrati, Komenksi, Xhon, Gjorgj, Maria & Bruneri). Mësimdhënia bashkëkohore kërkon planifikim të mirëfillt të materialit mësimor, metodologjisë mësimore dhe teknikave që do të përdoren për të arritur objektivat mësimore dhe synimet e shoqërisë. Mësimdhënia bashkëkohore ofron përdorimin e teknikave ndërvepruese, të cilat synojnë jo thjesht dhënien e njohurive, por

aftësimin e nxënësve për të përballur sfidat e jetës e për të marrë pjesë suksesshëm në jetën personale dhe profesionale.

Teknikat e të mësuarit janë: rrugët, mënyrat, ecurit dhe procedurat didaktike që nxënësit i përdorin gjatë procesit mësimor. Fjalori Edukimi në nocionin teknikë, theksohet se “përkrah metodave të mësimdhënies dhe të didaktikës qëndrojnë edhe teknikat pedagogjike, të cilat janë instrumente të gjetjes së rrugëve edukative”.(Grillo, 2002, p. 304).

Në literaturën pedagogjike dhe komunikimin e përgjithshëm profesional, zakonisht përdoret nocioni “teknikë” në mësim. Përveç këtij nocioni në literaturën didaktike edhe nocione të tjera si: mjete teknike, teknika arsimore etj.(Zylfiu, 2001, p. 276).Teknikat mësimore janë programe mësimore për lëndë të ndryshme që lidh teorinë dhe praktiken përmes pajisjeve të ndryshme, objekteve ose makinave që mund të përdoren për sqarimin e temës mësimore. Teknikat e mësimdhënies përfaqësojnë procedurat standarde didaktike të cilat përdoren nga mësimdhënësit për bashkëpunim me nxënës, për prezantimin e materialeve dhe aktiviteteve mësimore, me qëllim arritjen e objektivave pedagogjike.

”Teknikat në vetvete ndihmojnë në nxitjen e procesit të të kuptuarit dhe të menduarit të nxënësit përmes nevojës që ai të mendojë si një karakter që është i portretizuar Këto teknika sigurojnë edhe mundësit për një kuptim më të mirë nga ana e nxënësve të aftësisë që të kërkojnë në jetë edhe jashtë rolit dhe pozicioneve që ata i kanë qejf dhe tentojnë ti aprovojnë”.(Tamo&Karaj&Rapti, 2001, p. 139).Me fjalën teknikë kuptojmë tërësinë e mjeteve të ndryshme që mësimdhënësi dhe nxënësi i zbatojnë në procesin mësimor, si dhe përmbajtjen, metodat dhe komponentët e tjerë mësimor.(Zylfiu, 2011, p. 135).Për këtë arsye duhet që mësimdhënësit të ndërjegjësohen që: Më e rëndësishme është ajo që mësohet dhe jo teknika që përdoret. Pra, teknikat ndërvepruese duhen të përshtaten me lëndën e gjuhës shqipe dhe qëllimet e të nxënës.

Mësimdhënësi përmes përdorimit të teknikave të mësimdhënies, po i japin përmasa të reja mësimor, duke nxitur mendimin kritik dhe të nxënësve e pavarur. Metodatat dhe teknikat e të mësuarit janë procedura standarde që përdorin mësimdhënësit në bashkëpunim me nxënësit për paraqitjen dhe për zhvillimin e materialeve të veprimtarive mësimore, për të arritur qëllimet dhe objektivat mësimore.

Metodat dhe teknikat e diskutimit dhe punës me grupe kanë rëndësi të veçantë dhe kanë për qëllim që t'ua mësoj nxënësve shprehitë e të nxënës afatgjatë, të zhvillojnë menduarin kritik.

Përdorimi i teknikave të reja të mësimdhënies sygjeron nxënësin në qendër të aktiviteteve të të nxënësve, pastaj bashkëpunimin e nxënësve, duke u mbështetur në modelin e mësimin nga njeri-tjetri. Ky lloj i të mësuarit do të jetë më i suksesshëm. Nëse nxënësit përfshihen më shumë në veprimtari të ndryshme gjatë të nxënësve, edhe rezultatet do të jenë më të mira. Në përgatitjen e planit ditorë mësimdhënës saktësisht duhet të shënojë aktivitetet të cilat mendon që t'i organizojë për ta arritur rezultatet të nxënësve dhe kompetencën që synon të zhvillojë. Aktivitetet mësimore ndërliken nga teknikat mësimore.

Studime të ndryshme nga fusha e metodologjisë dhe mësimdhënies kanë treguar që mësimdhënës duhet të përdorë aktivitete të ndryshme me qëllim që të nxitë procesin e të lexuarit të shkruarit dhe të kuptuarit, përmes teknikave ndërvepruese si: DRTA, Insert, Ditari dy pjesësh, Ruaje fjalën e fundit për mua, Kubimi, Mendo, puno në dyshe, Shkrim i lirë, etj. Këto janë disa nga teknikat që nxisin të lexuarit, të shkruarit gjatë procesit të të mësuarit të nxënësve, teknika këto që realizohen në fazat të ndryshme të orës mësimore. Në fillim të orës së mësimin është e nevojshme që mësuesi të ketë ide se ç' lloj i të nxënësve është i përshtatshëm për nxënësit e tij dhe, si ta zhvillojë mësimin, që të lehtësojë të nxënësve.(Musai, 2014, p. 130). Por që të fitosh dhe përdorësh shprehitë e leximit- shkrimit duhet ndjekur një rrugë të gjatë dhe me plot çelësa, të cilët hapen një e nga një, kur di t'i përdorësh. (Esmallari, 2014). Të lexuarit është çelës kyç në të nxënësve. Të shkruarit dhe të folurit kanë të njëjtën lëndë të përbashkët, gjuhën dhe të njëjtin qëllim të përbashkët; komunikimin e ideve, informacionit dhe ndjenjave.

3.1. Teknikat mësimore që e bëjnë mësimin më efikas

Mësimdhënës duhet ta bëjë mësimin sa më interesant për nxënësit dhe në klasë të ketë dinamikë, sepse nëse mësimdhënës përdorë gjithmonë teknika të njëjta mësimi bëhet monoton dhe nxënësve u largohet interesi për njohurit e reja që merren. Andaj në mësimdhënies është shumë e rëndësishme përzgjedhja dhe përdorimi i teknikave që do të përdorë mësimdhënës në klasë. Përdorimi i teknikave të përshtatshme pedagogjike dhe metodologjike ndikojnë në mësimdhënien dhe të nxënësve efektivë. (QTKA, 2005).

Efektet e teknikave ndërvepruese mësimore të cilat sjellin disa ndryshime në punën mësimore të mësimdhënësit dhe të nxënësit, ndryshon mënyrën e mësimdhënies, planifikimit të orës mësimore, menaxhimit të klasës, zbatimit të metodave interaktive etj., ndërsa te nxënësi vërejmë këto ndryshime: aftësinë për të menduar në mënyrë kritike, demonstrimi i njohurive të kuptuara, përpjekja për të dhënë përfundime logjike, dëshira për të parashtruar pyetje, bashkëveprimi në klasë, rritja e interesimit për të dhënë ide të reja etj. Përdorimi i teknikave mësimore ndërvepruese rrit aktivitetet e pavarura dhe nxit nxënësit për të shtruar pyetje të cilat zhvillojnë aftësitë logjike dhe të menduarit kritik. Efektet e zbatimit të saj, ndikojnë në afirmimin e pozitës së nxënësit në ato faza të procesit mësimor në të cilat, në mësimin tradicional, ka qenë kryesisht pasiv. (Ismaili, 2012, p. 354). Për realizimin me sukses të teknikave ndërvepruese mësimdhënësi, gjatë planifikimit duhet t'i përshtat mënyrës se si mësojnë nxënësit, cilat teknika mundësojnë realizimin e përmbajtjes mësimore dhe të objektivave të caktuar. Varësisht nga përmbajtja mësimore mësimdhënësi mund të përdorë disa teknika ndërvepruese të mësimdhënies. Teknikat mësimore duke integruar një numër të konsiderueshëm të mjeteve mësimore ka për qëllim të zgjerojë dhe të thellojë njohuritë tek nxënësi. (Ismajli, 2012, p. 26).

E rëndësishme për t'u theksuar janë dhe teknikat e diskutimit dhe punës në grupe, ku çdo mësimdhënësi inkurajon bashkëpunimin dhe të nxënësit pjesëmarrës. Teknikat e diskutimit dhe punës në grupe kanë rëndësi të veçantë dhe kanë për qëllim që t'ua mësojë nxënësve shprehitë e të nxënësit afatgjatë, të zhvillojë menduarit kritik. Ndikim të madh ka në mënyrën se si nxënësit përpunojnë informacionin, në zgjidhjen e problemeve dhe bashkëpunimin me të tjerët.

Të gjitha këto, pra, shprehitë, njohuritë, vlerat janë të lidhura në njëra-tjetrën. Nxënësit sa më të zhvilluar që t'i kenë shprehitë e përpunimit informacionit, të bashkëpunimit, të shkrimit, të leximit, aq më në gjendje do të jenë që të bëjnë shkrime ku shprehin pikëpamjet e tyre rreth koncepteve apo problematikave të ndryshme. Secila teknikë përbënë një mjet për realizimin e qëllimit. Metoda dhe teknikat navatore bashkëkohore japin rezultate në formimin e shprehive të shoqërisë dhe dijes. Metoda novatore e diskutimit zgjojnë te nxënësit interesin e tyre dhe në klasë do të ketë gjithëpërfshirje.. Një mësimdhënie e mirë, është rezultat i përdorimit të teknikave të

mira në mësimdhënie, të cilat evoluojnë me kalimin e kohës, që do të thotë se edhe mësimdhënësit duhet të evoluojnë bashkë me kohën dhe të përdorin teknika të reja. Metodatat, teknikat e mësimdhënies mund të jenë të orientuara nga mësimdhënësi ose nga nxënësit. Sa më shumë të përdoren teknika mësimore në mësim, aq më efikas do të jetë nxënia për nxënësit dhe menaxhimi i klasës dhe të jetë si duhet(MASHT, 2014).

3.2.Llojet e teknikave ndërvepruese në përvetësimin e gjuhës

Për planifikimin e mësimit të gjuhës shqipe mësimdhënësi është kompetent për zgjedhjen e teknikave ndërvepruese të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Teknikat e përzgjedhura nga mësimdhënësi duhen përshtatur me aftësitë dhe njohuritë e mëparshme të nxënësve, me nevojat dhe kërkesat e tyre, me mjedisin(shkollën, klasën)dhe me materialin mësimor. (Rama, 2011, p. 18). Kemi një sër teknikash të ndryshme, ku njihet një numër i madhë i tyre, do të i prezantojmë disa nga ato: DRTA, Insert, Ditari dy pjesësh, Ruaje fjalën e fundit për mua, Kubimi, Mendo, puno në dyshe, Shkrim i lirë etj. Kombinimi i këtyre teknikave ndërvepruese gjatë procesit mësimor ka për qëllim të thyejë monotoninë e orës mësimore, që nxënësit të jenë aktive, të bëhen përgjegjës për të nxënit e tyre.

3.2.1.Teknika Kubimi-Është një teknikë me të cilën bëhet një shkrim për një periudhë të shkurtër kohore (2-4min.) rreth një teme të caktuar. Kjo teknikë ndihmon shqyrtimin e një teme në këndvështrime të ndryshme. Në fillim jepet tema për të cilën nxënësit kanë njohuri, p.sh. Libri, lulja, zemra, paraja druri, kompjuteri. Formohen grupet 5x6 anëtarë. Nxënësit udhëzohen të mendojnë për temën dhe ta përshkruajnë atë në mënyrë individuale sipas këtyre kërkesave: Përshkruani çfarë shihni dhe mendoni?

1.PËRSHKRUAJE-dukjen, formën, ngjyrën, madhësinë e objektit që e kemi temë.

2.KRAHASOJE-me diç tjetër, në çka është e ngjashme ose dallon.

3.SHOQËROJE-tregoni çfarë u kujton, i'u lidhë ndonjë ngjarje nga jeta me të.

4.ANALIZOJE- si është ndërtuar prej cilave pjesë përbëhet ajo?

5.ZBATOJE-ç'na duhet, përse e përdorim?

6.ARSYETOJE- është e mire apo e keqe, përse?

Kjo teknikë zbatohet në fazën e orës mësimore në Evokim dhe Reflektim.

Kubimi është teknikë e përshtatshme për aplikim edhe në orë të përforsimit dhe përsëritjeve e cila mund të zhvillohet në formë të lojës.(Rraçi&Kuqi, 2017, p. 40).

3.2.2.Mendo/puno në dyshe/shkëmbe me të tjerët

Teknika Mendo/puno në dyshe /shkëmbe me të tjerët është një veprimtari e shpejtë e të mësuarit në bashkëpunim, që i bën nxënësit të reflektojnë mbi tekstin dhe të ndihmojë njëri-tjetrin për t'u japin formë ideve dhe mendimeve të tyre. Kjo mund të bëhet gjatë leximit ose leksionit.(Gjokutaj, 2012).Mësimdhënësi përgatit paraprakisht pyetje, zakonisht pyetje te hapura, dhe u kërkon nxënësve që të shkruajnë një përgjigje rreth saj. Nxënësit bashkohen në dyshe dhe përpiqen të arrijnë së bashku në një formulim që përfshin idetë e të dyve. Mësimdhënësi u kërkon atë dyshe sa lejon koha , të bëjnë një përmbledhje 30 sekondëshe të diskutimeve të tyre. Kjo teknikë mund të përdoret në fazën e evokimit dhe të reflektimit.(KEC,2004).

3.2.3.Ruaje fjalën e fundit për mua

Teknika “Ruaje fjalën e fundit për mua” është një teknikë e cila shërben për t'i nxitur nxënësit të reflektojnë dhe të mendohen pas leximit. Nxënësi krijon mundësi për të diskutuar rreth një teksti me të gjithë klasën, qoftë ai tekst paraqitës apo tregimtar. Përmes kësaj teknike mund të tërhiqen edhe nxënësit e heshtur, të cilët mund të marrin pjesë në diskutime, sepse kjo teknikë i tërheq ata për të qenë aktiv sikur nxënësit tjerë. Hapat për realizimin e kësaj teknike janë:

1. Gjatë leximit të një pjese, nxënësit duhet të gjejnë një ose më shumë pjesë, të cilat janë interesante dhe që ia vlen të diskutohet për atë ose ato pjesë.
- 2.Pjesa e zgjedhur shkruhet në një skedë bashkë me numrin e faqes prej së cilës është shkëputur.
3. Në anën e pasme të skedës shkruhet një koment, nxënësi mund të shkruajë që nuk pajtohet
- 4.Ditën tjetër nxënësi e sjellë në klasë pjesën e shkruar në skedë dhe mësimdhënësi mund t'i kërkojë ta lexojë me zë të lartë.
5. Pasi të lexohet pjesa mësimdhënësi u kërkon nxënësve tjerë të komentojnë apo reagojnë. Duhet të kemi kujdes që diskutimi të jetë i përqendruar. Edhe mësimdhënësi mund të bëjë komente mbi pjesën e lexuar.

6. Për ta mbyllur diskutimin, mësuesi fton nxënësin që bëri zgjedhjen e pjesës, të lexojë komentin e tij. Diskutimi përfundon këtu, nxënësi që e ka zgjedhur pjesën ka të drejtë të thotë fjalën e fundit. Edhe pse është e mundimshme që pasi të thuhet fjala e fundit nga nxënësi, nxënësit tjerë mund të reagojnë dhe është problem që të ndalen nxënësit tjerë, por rregullat e kësaj teknike janë të tilla.

7. Mësuesi fton një nxënës tjetër që të lexojë pjesën e tij të parapëlqyer dhe e fillon kështu diskutimin e ri nga e para. (KEC, 2004, p. 45).

3.2.4. Kllasteri

Është një nga teknikat e mendimit kritik dhe këtu ka kuptimin si “Pema e mendimeve”. Është një teknikë që nxit nxënësit të mendojnë lirshëm dhe hapur rreth një çështjeje. Kërkon një strukturë të mjaftueshme për të nxitur të menduarit për lidhjet mes ideve. Kllasteri mund të përdoret në dy faza edhe në evokim edhe në reflektim. (Steele & Meredith & Temple, 1998, p. 58). Përdoret për të nxitur të menduarit përpara se të fillojmë ta analizojmë në hollësi temën mësimore, gjithashtu përdoret edhe për të bërë përmbledhjen e asaj që është mësuar. Kllasteri është një veprimtari e shkruar, që mund të shërbejë si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të shkruarit, në mënyrë të veçantë, për ata që u mungon një dëshirë e tillë. Pastaj tërë këtë punë ata mund ta prezantojnë para nxënësve dhe kështu mund të hapet një diskutim lidhur me temën në fjalë. Më shpesh është teknikë për t’u njohur me njohuritë e dikujt rreth një teme të caktuar. (KEC, 2004, p. 81).

3.2.5. Insert- është një teknikë që i lejon nxënësit ta kontrollojnë gjallërisht shkallën e të kuptuarit të tyre gjatë leximit. Nëpërmjet kësaj teknike sigurohet pjesëmarrja e qëndrueshme e nxënësve në mësim dhe një teknikë që siguron një të nxënë të shëndetshëm për nxënësit. Gjatë leximit nxënësit udhëzohen që të vendosin shenjat e mëposhtme: “√”, “+”, “-“.

“√” vendoset shenja “√”(kontrollo), nëse diçka që lexon pohon atë që e dini ose mendoni se e dini.

“+” vendosni një “+”(plus), nëse një pjesë e informacionit që ndeshni është i ri për ju.

“-“ vendosni një “-“(minus), nëse një ose disa prej informacioneve që lexoni është e ndryshme nga ajo që dini ose mendoni se e dini.

“?” vendose një “?”(pikëpyetje), nëse ka informacion që është i paqartë për ju ose ka diçka që ju duhet të dini më shumë rreth këtij informacioni.

√	-	+	?

Grafika Nm.1. Paraqitja grafike e teknikës: Insert

Kjo teknikë përdoret në fazën e realizimit të kuptimit. Kjo teknikë i përfshin nxënësit në veprimtari të gjëra të nxëni, pasi nxënësit gjatë ushtrimeve të kësaj teknike iu duhet të lexojnë të shkruajnë dhe të flasin. Kjo teknikë mund të zhvillohet në mënyrë individuale, por edhe në punë me grupe, kur kemi të tekste dhe informacione të gjata. Në orën e gjuhës shqipe dhe të lexuarit, kryesisht gjatë dhënies së informacioneve të reja ka vlera të jashtëzakonshme.(Gjokutaj, 2012, p. 281).

3.2.6.Pesëvargëshi

Është një poemë e cila kërkon përmbledhjen e informacionit dhe të materialeve në një shprehje të saktë e cila përshkruan apo reflekton rreth temës. Kjo teknikë mund të përdoret në dy faza të orës mësimore evokim dhe reflektim. Pesëvargëshi është një vjershë me pesë rreshta’

- 1.Rreshti i parë është përshkrimi me një fjalë i temës (zakonisht emër).
- 2.Rreshti i dytë është përshkrimi me dy fjalë i temës (zakonisht dy mbiemër).
- 3.Rreshti i tretë janë tri fjalë që shprehin veprim të temës.
- 4.Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë, që shpreh qëndrimin për temën.
- 5.Rreshti i fundit është një fjalë sinonime, që ripërcakton thelbin e temës.

Pesëvargëshi është një teknikë që përdoret në fazën e reflektimit, meqë bën përmbledhjen e informacionit të marrë. Në lëndën e gjuhës shqipe pesëvargëshi bën një shërbim të madh. Si teknikë tërheqëse i bën që nxënësit të merren me të, të përkufizojnë dhe ndërtojnë dhe krijojnë skema në lidhje me mendime, e çështje të caktuar. (Gjokutaj, 2012, p. 282).

3.2.7.Ese 5-10 dhe shkrime të lira

Ese dhe shkrime të lira përdoren si teknika të cilat ndihmojnë për të sistemuar nxënësit mendimet e tyre përmes të shkruarit. Gjatë shkrimit të lire nxënësit shkruajnë pa u ndalur, me qëllim që të shkruarit e tyre të burojnë në mënyrë të tillë që ata të mos kenë frikë nga kritikën dhe korrigjimet. Shkrimet e lira të kësaj natyre i përgatisin nxënësit për veprimtari krijuese të shkruar.(Gjokutaj, 2012).

3.2.8.DRTA

(Veprimtaria e të Menduarit, Lexuarit dhe Drejtuarit) - është një veprimtari gjatë së cilës lexuesit nxiten të mendojnë, të parashikojnë dhe të mbajnë shënime. Ky aktivitet ndërtohet në bazë të tri pyetjeve:

Ç'mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Çfarë provash keni?

Grafika Nm.2..Paraqitja grafike e teknikës: DRTA. (Veprimtaria e të Menduarit, Lexuarit dhe Drejtuarit).

Për të plotësuar tabelën, mësuesi bën pyetje, të cilat e përqendrojnë vëmendjen e nxënësve në titujt, ose ilustrimet e zgjedhura. Mësimi mund të fillojë me një diskutim rreth titullit të njësisë dhe duke u bazuar në pyetjet: Për çfarë mendoni se mund të bëjë fjalë kjo temë? Pse mendoni kështu?! Parashikimet shkruhen në ndarjen e parë të tabelës ose në dërrasën e zezë. Mësuesi duhet të pranojë të gjitha parashikimet e bëra nga ana e nxënësve. Pas këtyre diskutimeve fillestare, nxënësit do të lexojnë në heshtje tekstin, deri në çastin e caktuar që më parë nga mësuesi, për të nxjerrë pikat apo provat që tregojnë nëse parashikimet e tyre janë të sakta apo jo. Në këtë pikë diskutimi vazhdon me parashikime tjera, të dhëna nga nxënësit, bazuar në leximin e tyre deri në këtë fazë. Këto veprime përsëritën derisa teksti të mbarojë.(Gjokutaj, 2012, p. 283).

3.2.9. Di / dua të di / mësova

Teknika Di/dua të di/ mësova e organizuar në format dhe të një tabele të përbërë nga tri shtylla. Gjatë realizimit të kësaj teknike nxënësit duhet të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë në mënyrë të kujdesshme përgjigjet për pyetjet që kanë parashtruar gjatë leximit të tekstit. Kjo teknikë mund të përdoret në tri fazat e orës mësimore, por edhe vetëm në fazën realizim të kuptimit.

1. Është e lehtë dhe e përshtatshme që të aplikohet gjatë realizimit të orës mësimore.

2. Në tabelë përball nxënësve vizatohet një tabelë e ndarë në tri pjesë.

3. Di/ dua të di/ mësova, shtrohet tema që do të përpunohet.

4. Plotësojnë tabelën.

Di	Dua të di	Mësova

Grafika Nm.3..Paraqitja grafike e teknikës: Di/Dua të di/Mësova

Në kolonën e parë "Di", nxënësit do të shkruajnë atë informacion që nga leximi u duket i njohur.

Në kolonën e dytë "Dua të di", do të shkruhen pyetjet, ose kërkesa të nxënësve, rreth çështjeve për të cilat nxënësit kërkojnë të dine më tepër.

Në kolonën e tretë "Mësova", nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësuan nga teksti. (Gjokutaj, 2012, p. 281).

3.2.10. Rrjeti i diskutimit

Rrjeti i diskutimit është një teknikë që përcaktohet një pyetje binare, një pyetje që mund t'i përgjigjemi pozitivisht PO, ose negativisht JO, e cila prek çështjen e thelbit nga teksti. Teknika e rrjetit të diskutimit ka përparësi, sepse i vë njerëzit në punë, në çifte, katërshe e deri në gjysmën e klasës. Debati që pason i bën nxënësit të diskutojnë idetë e tyre me njëri-tjetrin. Të gjithë këta hapa kërkojnë shkallën më të lartë të pjesëmarrjes dhe të mendimit nga ana e nxënësve dhe, nga ana tjetër, i bën ata të argumentojnë idetë e tyre me zë të lartë, duke u përpjekur të bindin kundërshtarët që i kanë përpara vetes.

Diskutimi vazhdon sipas këtyre udhëzimeve:

- ❖ Grupet duhet të përkrahen që ta lënë çdonjërin të flasë në grupin e tyre sipas radhës,
- ❖ Duhet të nxiten të dëgjojnë me kujdes çfarë kanë thënë kundërshtarët përpara se të bëjnë paraqitjen e tyre.
- ❖ Cilido që ndryshon qëndrim gjatë diskutimit, mund të lëvizë në grupin tjetër.
- ❖ Nëse debati vazhdon më shumë se 15 minuta, nxënësve u kërkohet të ndalen dhe të shkruajnë argumentet më bindëse që kanë dëgjuar. Si përfundim një vullnetari i kërkohet nga secili krah të bëjë një përmbledhje nga ajo që është diskutuar. (KEC, 2004).

3.2.11. Diagrami i Venit

Është një teknikë me anë të së cilës evidentohen elementet e përbashkëta dhe atyre që dallohen ndërmjet dy koncepteve, objekteve, personazheve etj. Në gjuhë shqipe p.sh. ku mund të krahasohen pjesët e ndryshueshme të ligjëratës etj. Ky diagram përdoret për të krahasuar dy e më shumë personazhe, për të nxjerrë në pah gjërat e veçanta dhe të përbashkëta që kanë ato. Ky diagram përdoret gjatë fazës së reflektimit. (Rraçi&Kuqi, 2017).

Ditarët e të nxënit - janë ditarë dy ose tri pjesëshe, që përdoren për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngusht materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e tyre. Kjo teknikë përdoret në fazën e realizimit të kuptimit dhe në fazën e reflektimit. Për të bërë ditarin dypjesësh shkruhet një vijë vertikale në mes të fletës së fletores. Në anën e majtë shkruhen ato pjesë të tekstit, që iu tërheqin më shumë vëmendjen nxënësve, që tu kujtojnë diçka, që i intrigojnë më shumë, ose përgjithësisht japin mendime dhe opinione rreth çështjeve të ndryshme, kurse në anën e djathtë të fletës shkruhen komentet për pjesën e zgjedhur.

Citati	Komenti

Grafika Nr.4. Paraqitja grafike e teknikës: Ditarët e të nxënit

Vazhdohet me pyetje dhe përgjigje:

- ❖ Ç'elemente kishte citati që intrigoi më shumë?
- ❖ Ç'ju bëri të mendoni citimi?
- ❖ Çfarë pyetje ju lindën nga citimi?(Gjokutaj, 2012).
- ❖

3.2.12. Teknika e diskutimit

Dallimi midis një diskutimi të gjatë dhe atij që përfundon në një diskutim, ku vetëm mësimdhënësi flet dhe nxënësit rrin të heshtur, është shpesh, i vështirë për t'u kapur. Zakonisht diskutimet dalin të mira, atëherë kur drejtimin e tyre e përcakton kureshtja e nxënësve. Mësuesi luan rol kyç lehtësues.(J.T.dillon,1988)ka përcaktuar katër teknika, përmes së cilave mësimdhënësi bën të mundur që diskutimi të vazhdojë dhe të ruaj përqendrimin mbi nxënësit.

1.Pohimet- Pohimet janë mënyra e shprehjes së reagimit të të kuptuarit për sqarime të mëtejshme për atë që thuhet. Ato janë më të drejtpërdrejta sesa pyetjet, andaj dhe ngjallin një reagim më të lire.

2.Pyetjet-Zakonisht nxënësit diskutojnë rreth pyetjeve të tyre më shumë sesa për pyetjet e mësuesit. Ndaj mësuesit duhet të kultivojnë mënyra se si t'u kërkojnë nxënësve pyetje rreth tekstit. Çfarë pyetjesh mund të dalin nga ky tekst?; Çfarë kemi lënë pa diskutuar deri më tani?;Çfarë nuk ju duket e qartë deri më tani etj?.

3.Shenjat-Për shkak se komentet e mësimdhënësit nuk mbajnë shpesh peshë më të madhe në klasë(pra mësuesi fletë shumë).Një mimikë pyetëse mund të kërkojë sqarime të mëtejshme, duart e zgjatura përpara, u japin nxënësve mesazhin se duhet të bien dakord me njërin prej dy argumenteve, e nxit nxënësin që po lufton të gjejë fjalët e duhura, që t'i jape jetë idesë së vet.

4.Heshtja-Kur hidhet një pyetje për diskutim nxënësve u jepet kohë të mendojnë. Një pritje në heshtje prej 3, 4 ose 5 sekondash shërben si një motivues i forte për dike që të zbrazëtinë. E nëse nuk është mësuesi ai që e mbush heshtjen, do të përpiqet ta bëjë këtë dikush tjetër. (KEC, 2004).

3.3.Rëndësia e teknikave në mësimdhënien e gjuhës

Rëndësia e përdorimit të teknikave të ndryshme ndërvepruese në procesin mësimor që nxisin të lexuarit, të shkruarit dhe të kuptuarit tek nxënësit si rrugë për nxënie, është një faktor kryesor në zhvillimin e procesit edukativo-arsimor. Ky proces kërkon të arrihet dhe promovohet përmes teknikave ndërvepruese të cilat ofrojnë nxënësin tek teksti dhe e bëjnë atë që të gjejë kurajë për të shpjeguar, analizuar informacionin. Këto teknika, sjellin gjallëri dhe gjithëpërfshirje të nxënësve

në procesin e të lexuarit dhe të kuptuarit. Ato nuk janë të kufizuara nga krijimtaria dhe imagjinata e mësimdhënësve dhe nxënësve. E rëndësishme është që mësimdhënësit dhe nxënësit bëjnë diçka të kuptimshme në secilën fazë të orës mësimore.(Stele&Meredith&Temple, 1998).Pavarësisht se cilat teknika të punës mësimore mësimdhënësi ka vendosur t'i aplikojë gjatë orës mësimore, ai mundë të bëjë edhe kombinimin e tyre me qëllim që të nxisë aktivitetin e përgjithshëm të nxënësit.

Rëndësia e përdorimit të teknikave duhet të ketë kohën e caktuar të realizimit të një teknike, ajo nuk duhet të tejkalojë kohën e paraparë për realizimin e sajë. “Mësimdhënia është një detyrë e vështirë dhe komplekse dhe kërkon njohuri, aftësi dhe shprehje të shumta” (Musai, 2003, p. 11).Në mësimdhënien bashkëkohore procesi mësimor realizohet duke u mbështetur në teknikat ndërvepruese, përmes së cilave nxënësit mësojnë për të vlerësuar, reflektuar, zbuluar dhe për të zgjidhur problem të ndryshme. Procesin mësimor është në veprimtari që ndryshon vazhdimisht, në të cilin nxënësit kryesisht janë dëgjues dhe pjesëmarrës aktiv.

Qëllimi kryesor i përdorimit të çdo teknike mësimore është që me një përdorim sa më të gjerë dhe sa më funksional të mënjanohet verbalizmi dhe tradicionalizmi në punën mësimore dhe në procesin e njohjes dhe të ngrihet cilësia e punës mësimore. Përdorimi i teknikës mësimore ndikon pozitivisht në proceset e punës mësimore. Kjo ushtron ndikim pozitiv në organizimin e një strategjisë bashkëkohore, në përparimin dhe përsosjen e punës pedagogjike, në zgjedhjen dhe përdorimin e metodave, formave dhe veçorive të tjera të organizimit të punës. (Zylfiu, 2011, p. 136).Në punën mësimore, përdorimi i teknikave shpie në realizimin e qëllimeve dhe detyrave edukative dhe arsimore. (Lambright, 1995) thekson se nxënësit bëhen më kreativ kur janë të kyçur në grupe duke dëgjuar mendimet e të tjerëve, idetë etj. Nxënësit përfshihen me dëshirë në detyra për zgjedhjen e problemeve të ndërlikuara dhe shfaqin nivele të larta të menduarit në

marrjen e vendimeve.(Stele&Meredith&Temple, 1998).Nxënësit bëhen më aktiv në orë dhe ndihen më të lirë kur njësia mësimore realizohet me anë të teknikave të ndryshme. Përdorimi i drejtë i teknikave lehtëson punën dhe e bënë më atraktive procesin mësimor. Pasi që kemi një numër të madhe të teknikave, ato na mundësojnë në zgjedhjen e tyre në bazë të përshtatshmërisë së njësisë mësimore. Pavarësisht se cilat forma, teknika të punës mësimore mësimdhënësi ka vendosur t'i aplikojë gjatë orës mësimore, ai mundë të bëjë edhe kombinimin e tyre me qëllim që të nxisë aktivitetin e përgjithshëm të nxënësit.

Një mësimdhënie e mirë i motivon nxënësit që të kenë dëshirë për të mësuar, i inkurajon ata për të menduar në mënyrë të pavarur mbi temën e caktuar dhe i ndihmon mësimdhënësit që të krijojë një ambient të përshtatshëm për punë. Themi i motivon nxënësit, sepse aty shihet aftësia e mësimdhënësit i cili di të drejtojë një orë mësimore duke ju bërë më interesante njësinë mësimore duke i inkurajuar nxënësit që të thonë atë çfarë ata mendojnë për njësinë, prandaj mund të themi se kjo orë mësimore është e destinuar të ketë sukses edhe për mësimdhënësin edhe për nxënësin. Andaj, jo rrallë thuhet së mësimdhënësi i mirë i tërheq nxënësit sikur magneti thërrmijat e atomit.(Sylejmani, 2012, p. 71).

4.1. Metodat mësimore dhe rëndësia e tyre

Fjala "metodë" rrjedh nga gjuha greke (methodos), që do të thotë rrugë ose mënyrë me të cilat udhëhiqemi me rastin e realizimit të detyrave dhe veprimeve të punës. Në punën mësimore, përdorimi i metodave shpie në realizimin e qëllimeve dhe detyrave edukative dhe arsimore. Cilësia e mësimin varet edhe nga metodat mësimore dhe nga zgjedhja e drejtë e tyre gjatë organizimit të procesit mësimor.(Raçi& Kuqi, 2017 , p. 15).

(Gjokutaj, 2012, p. 202) thekson se: "fjala "metodë" nuk ka të njëjtin kuptim me fjalët: "strategji" dhe "teknikë", të cilat përdoren kohët e fundit në kuptimin e realizimit të mësimdhënies. Metodat kanë rëndësi të veçantë në teorinë dhe praktikën e punës mësimore, pasi që ato përcjellin tërë ecurinë e zhvillimit të procesit mësimorë. Procesi i mësimdhënies është kompleks dhe për ta thjeshtësuar këtë proces duhet përdorur metoda sa më efikase gjatë punës me nxënësit. Nxitja e interesimit për mësim është një çështje madhore për mësimdhënësin.

Metodat e mësimdhënies janë mënyra të punës në mësimdhënie, edhe atë si të mësimdhënësit, ashtu edhe të nxënësit, ngase edhe mësimdhënësit edhe nxënësit janë aktiv gjatë mësimi.(Sylejmani, 2012, p. 19).

Përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës nxit veprimtarinë e nxënësve dhe mundëson të nxënit e qëndrueshëm. Përdorimi i drejtë metodave mësimore ndikon edhe në formimin e personalitetit të nxënësve, duke i aftësuar dhe përgatitur ata për jetë dhe punë, sidomos për vet arsimim dhe vetë mësim.(Zylfiu, 2011, p. 276).

Metodat mësimore ndihmojnë vënien e takimit të nxënësve me përmbajtjet mësimore dhe përmes përdorimit të teknikës mësimore, i nxisin nxënësit që t'i transformojnë ato, njëherit që ta transformojnë edhe vetën, duke fituar njohuri, zhvilluar shkathtësi dhe formuar shprehje jetësore edhe punuese në përgjithësi dhe rreth kulturës gjuhësore në veçanti.(Garo, 2011, p. 68).

Kërkesa për përdorimin e metodave mësimore rrjedh nga thelbi i vet organizimit punës mësimore dhe struktura didaktiko-metodike e artikulimit të procesit mësimor. Për një mësimdhënie të suksesshme është shumë e rëndësishme përzgjedhja dhe përdorimi i metodave që do të përdorë mësimdhënësi. Mësimdhënësi duhet ta bëjë mësimin sa më interesant dhe në klasë të ketë dinamik, sepse nëse mësimdhënësi përdor gjithmonë metoda të njëjta mësimi bëhet monoton dhe nxënësve u largohet interesi për njohurit e reja që merren.

Çdo mësimdhënës për të realizuar një orë efektive mësimore në klasë, mund dhe duhet të përzgjedhë atë metodë mësimore e cila është më e pranueshme dhe më e përshtatshme për një orë të caktuar mësimi. Duke theksuar që sikurse orët mësimore janë të ndryshme, ashtu edhe metodat për realizimin e tyre janë të ndryshme. Përdorimi i metodave të përshtatshme ndikon në mësimdhënien dhe nxënit efektiv dhe duhet pasur parasysh që sa më shumë t'u shmangemi përdorimit të metodave tradicionale.

Përzgjedhja e metodave dhe kombinimi i tyre është punë e mësimdhënësit. Nganjëherë thuhet se metodë e mire është ajo të cilën e zotëron mësimdhënësi. Porse mësimdhënësi duhet të zotërojë të gjitha metodat, tërësia e cilave përfshin shumëllojshmërinë e lëndës mësimore.(Sylejmani, 2014, p. 27).Mësimdhënësi ka të drejtë të zgjedhë metodat dhe strategjitë bashkëkohore të planifikimit të mësimdhënies në përputhje me objektivat mësimore dhe kapacitetet që kanë nxënësit.

Metodat të cilat zakonisht përdoren në organizimin e procesit mësimorë të gjuhës shqipe janë:

- ❖ Metoda e dialogut (bashkëbiseduese)
- ❖ Metoda e diskutimit
- ❖ Metoda e demonstrimit
- ❖ Metoda e punës me tekst
- ❖ Metoda e aktivitetit praktik
- ❖ Metoda e parashtrimit

4.1.1.Metoda e dialogut(bashkëbiseduese)

Në organizimin e punës mësimore, metoda e dialogut ose e bashkëbisedimit, ose siç quhet ndryshe; erotematike, zë një vend të posaqëm, si për nga vlera metodike që ka, ashtu edhe për nga denduria e përdorimit, përmes së cilës zhvillohen marrëdhënie bashkëvepruese në punën mësimore. (Zylfiu, 2001, p. 287).Kjo metodë mund të përdoret dhe të gërshetohet suksesshëm edhe me metoda të reja bashkëkohore, sepse përdoret si e veçantë dhe bashkë me metoda të tjera gjatë planifikimit të mësimdhënies në përgjithësi e sidomos në lëndën e gjuhës shqipe ne veçanti. Me ndihmën e metodës së dialogut, mësimdhënësi dhe nxënësit harmonizojnë ndikimet dhe bashkëveprimet në procesin mësimor, japin dhe marrin informacione të përpikta mbi cilësinë e angazhimit të ndërsjellë psiko-intelektuale dhe për rezultatet e arritura. Metoda e bashkëbisedimit zhvillohet në të gjitha etapat e organizimit të mësimin, si në rastin e përvetësimit të njohurisë, të zhvillimit të shkathtësisë dhe të formimit, ushtrimit, kontrollimit dhe vlerësimit të përvetësimit të tyre. Ecuria dhe mbarëvajtja e orës së mësimin në gjuhë shqipe janë të kushtëzuar nga zgjedhja dhe zbatimi i një metode sa më të efektshme, i një metode që merr parasysh dhe mbështetet në natyrën dhe vëllimin e informacionit të ri, në kushte reale të klasës dhe në formimin gjuhësor e letrar të çdo nxënësi. Bashkëbisedimi është një metodë që mund të praktikohet në një pjesë të mirë të etapave të orës së mësimin: në fillim të orës, gjatë paraqitjes së njohurive të reja ,gjatë praktikës së drejtuar, gjatë punës në grup, gjatë përpunimit të informacionit, gjatë kontrollit formues dhe kontrollit të praktikës së pavarur etj. Mësimdhënësi duhet të mbështetet në përvojën vetjake të nxënësve, pa u trembur se ata nuk zotërojnë njohuri të plota për çështjet e konceptet që trajtohen në orën e mësimin. Për të pasur efektivitet në bashkëbisedim, mësimdhënësi i nxit nxënësit që ata të bëjnë vëzhgime gjuhësore ,të lexojnë e të nënvizojnë për të veçuar, për të analizuar,për të krahasuar etj.

Bashkëbisedimi si metodë mësimdhënësi duhet ta shfrytëzojë që t'u zhvillojë edhe kulturë në të foluritë, pasi i nxit ata për të shprehur mendimet me fjali të ndërtuara saktë nga ana gjuhësore. Kjo metodë mundëson pjesëmarrjen aktive të të gjithë nxënësve në mësim dhe nxit veprimtarinë e tyre mendore. Pjesëmarrja aktive zhvillon të menduarit logjik e kritik, rrit të nxënësit aftësinë e përgjegjësinë për t'u përgjigjur sa më saktë. Bashkëbisedimi dhe gjithë struktura e orës së mësimit duhet të bëjnë të mundur që mësimi të ketë ritëm, me çaste të vëmendjes intensive dhe të reflektimit. Bashkëbisedimi është lidhur ngushtë me të pyeturit. Të përdorësh bashkëbisedim, nuk do të thotë të lësh mënjane metoda e forma të tjera të punës. Çelësi i suksesit të bashkëbisedimit qëndron në faktin se sa i zoti është mësimdhënësi që të kombinojë metoda të tjera që mbështetin bashkëbisedim.(Rama, 2011, p. 115).

4.1.2. Metoda e diskutimit

Mund ta hasim me lloje të interpretimeve apo termave të ndryshme si: metoda bashkëbiseduese, dialoguese, e diskutimit dhe e pyetjeve-përgjigjeve. Diskutimi është një nga metodat e thjeshta që përdorët për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin e nxënies së letërsisë në klasë. Kjo metodë është një lloj lidhje e afërt mësimdhënës-nxënës dhe mundëson shkëmbim idesh nga të dy palët në diskutim për t'i shprehur qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre. Diskutimi është një nga metodat mësimore që përdorët në mënyra të ndryshme. Kjo metodë krijon në mësim atmosferë të gjallë, të ngrohtë, të natyrshme dhe revolucionare. Diskutimi mësimor krijon mundësi që të vendoset një lidhje më e mirë në mes të studimit individual dhe atij kolektiv. Zakonisht mësimdhënësit metodën e diskutimit e përdorin në orët e përforcimit dhe të analizës së teksteve letrare dhe joletrare. Kjo metodë nxit nxënësit të mendojnë dhe të gjykojnë qartë në vlerësimet e tyre. Mësimdhënësit duhet të praktikojnë këtë metodë në atë mënyrë, që nxënësit e tyre ta kuptojnë sa më lehtë dhe ta praktikojnë sa më mirë atë, t'i mësojnë rregullat dhe parimet e saj dhe më pas të dijnë t'i zbatojnë me përpikëri, për të arritur suksesin e duhur në nxënie. Kjo metodë është efektive kur çdo nxënës zhvillon njohuritë personale rreth temës së diskutuar. (QTKA, 2005, p. 30).

4.1.3. Metoda e demonstrimit

Metoda e demonstrimit- konkretizimit mbështetet edhe në aspektin didaktiko- metodik e thjeshtëson procesin e njohjes në mësim. Kjo metodë ndihmon organizimin e vrojtimit të drejtpërdrejtë dhe të veprimit të tërthortë të situatave gjuhësore. Prandaj, thuhet se metoda e demonstrimit mbështetet kryesisht në parimin e konkretizimit, të aktivitetit të vetëdijshëm dhe në parimin e lidhjes së teorisë me praktikën mësimore dhe jetësore.

Metoda e demonstrimit motivon nxënësit të vërejnë, analizojnë, krahasojnë, diferencojnë, të gjejnë ngjashmëritë dhe dallimet, të bëjnë analizën dhe sintezën e karakteristikave themelore të dukurive dhe të proceseve gjuhësore, të formojnë përfytyrime audio-vizuale, koncepteve, të nxjerrin konkluzione dhe të ushtrojnë t'i zbatojnë në praktikën gjuhësore në formë të ushtrimeve të leximit letrar dhe të shprehurit me gojë dhe me shkrim. (Brada, 2005, p. 120).

4.1.4. Metoda e punës me tekst

Për dallim nga lëndët e tjera në mësimin e gjuhës shqipe fjala e shkruar dhe e shtypur gjen përdorim të gjerë dhe të duhur. Përdoret në formë të krijimeve të nxënësve, si tekst shkollor, lekturë letrare, literaturë ndihmëse (doracak, fletore pune, fjalor, enciklopedi), dhe si shtyp për nxënësit, ditor dhe periodikë, revistë etj. Të gjitha këto modalitete të fjalës së shkruar dhe të shtypur mund të sublimohen në destinacionin e tekstit shkollor... Kjo metodë mund të përdoret në të gjitha etapat e njohjes në mësim, si në rastin e përvetësisë ashtu edhe në rastin e shndërrimit të tyre në prone të përhershme aktive, përkatësisht, edhe me rastin e organizimit të përsëritjes dhe të përforcimit, të ushtrimeve, të kontrollimit dhe të vlerësimit të njohurive të nxënësve. (Musai, 2008).

4.1.5. Metoda e aktivitetit praktik

Metoda e aktivitetit praktik nënkupton rolin primar të mësimdhënësit, por edhe më shumë të nxënësit në procesin e përvetësimit, zotërimit dhe zbatimit praktik të njohurive, të shkathtësive dhe të shprehive nga gjuha, nga kultura e të shprehurit me gojë dhe me shkrim, etj. Nga mësimdhënësi kërkohet që të peshojë drejt përmbajtjet gjuhësore, të cilat duhet dhe mund t'i përvetësojë dhe zotërojnë nxënësit me ndihmën e aktivitetit praktik mësimor.

Duke njohur nxënësit me objektivat, mjetet dhe mënyrat elementare të punës, duhet ushtruar nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur, të zotërojnë pengesat dhe vështirësitë, të nxiten të gjejnë mënyra dhe mjete më adekuate pune dhe veprimi, të nxjerrin konkluzione dhe t'i zbatojnë edhe në e pavarur në shtëpi dhe gjetiu. Metoda e aktivitetit praktik nënkupton edhe aftësimin e nxënësit për të përdorur drejt teknikën mësimore, sidomos mjetet teknike për incizime dhe projekte në terren (përdorimi i magnetofonit, kamerës, aparatit fotografik etj), por edhe për të përdorur teknikën kompjuterike për mësim të pavarur dhe të programuar. (Rama, 2011).

4.1.6. Metoda e parashtrimit

Komunikimi verbal-me gojë i njëanshëm (një kahësh) i mësimdhënësi me nxënësin dhe anasjelltas, emërtohet si metodë monologjike apo e parashtrimit. Mësimdhënësi parashtron, shpjegon, sqaron, kumton përmbajtjet e përbëra për të cilat nxënësit nuk kanë përvojë, as njohuri të mjaftueshme as të duhura. Mund të parashtrorë edhe atëherë, kur konsiderohet se parashtrimi do të shërbejë si gjedhe imitimi dhe identifikimi për parashtrimin e mendimeve në mënyrë të plotë, koncize, sistematike, të argumentuar, të qartë, me gjuhë të pastër, të kuptueshme për nxënësit, të cilat i pranojnë informacionet e caktuara. Nxënësit parashtrorë përmbajtjet e njohura në formë të riprodhimit aktiv, në të gjitha etapat e mësimin, si në rastin e shtjellimit t njohurisë, të shkathtësisë dhe të shprehisë së re, në fillim, gjatë dhe në mbarim të orës mësimore, ashtu edhe në rastin e organizimit të përsëritjeve dhe të përforcimit të ushtrimeve, kontrollimit dhe të vlerësimit.

Parashtrimi i mësimdhënësit dhe i nxënësit nuancohet si përshkrim, shpjegim, rrëfim dhe si ligjëratë. Përshkruhen me gojë apo me shkrim tiparet e jashtme të objekteve, të dukurive, të proceseve natyrore dhe zhvillimeve shoqërore, të cilat mund të shërbejnë drejtpërsëdrejti, apo në mënyrë të tërthortë, si burim i njohurive nga gjuha dhe letërsia, apo burim, mjet dhe mënyrë e ushtrimeve të të shprehurit me gojë dhe me shkrim (Brada, 2005, p. 123).

5.Format e organizimit të punës mësimore

Çështje e organizimit të punës mësimore është një nga pjesët tejet të rëndësishme të teorisë didaktike dhe praktike të organizimit të veprimtarisë edukative dhe arsimore. Sistemi klasë-orë i organizimit të punës mësimore edhe në kushtet e tanishme bashkëkohore të veprimtarisë edukative dhe arsimore ka ruajtur aktualitetin e zbatimit praktik. Puna mësimore bashkëkohore në organizimin e përgjithshëm përfshin disa modalitete të organizimit të formave të punës të cilat zakonisht trajtohen në kuadër të dy sistemeve didaktike të organizimit mësimor dhe këto janë:

1) Sistemi direkt i organizimit të punës mësimore dhe

2) Sistemi indirekt i organizimit të punës mësimore (Zylfiu, 2001.f.183-185).

Sistemi direkti i organizimit të punës mësimore ndahet në:

1. Puna mësimore në formë të organizimit frontal-kolektiv (ballor)

2. Puna mësimore në grupe

3. Puna mësimore në çifte (tandem) dhe

4. Forma individuale e punës mësimore

5.1.Puna mësimore në formë të organizimit frontal-kolektiv (ballor)

Kjo formë e punës mësimore karakterizohet nga organizimi i përbashkët i mësimit me të gjithë nxënësit e një klase, në kohë të njëjtë dhe ka karakter të punës kolektive.

Me këtë formë, puna mësimore zhvillohet me tërë klasën, nën udhëheqjen e mësimitdhënësit. Ky koncept i punës mësimore kërkon domosdo që mësimitdhënësi, duke përdorur mjete të ndikimit audio dhe vizual, ta përshtatë ritmin dhe shkallën intelektuale të ligjërimeve të veta, në mënyrë efektive që të mund të ndiqet nga nxënësi mesatar. Meqë ecuria e punës mësimore zhvillohet kryesisht me një ritëm të përcaktuar, sipas një mesatareje të klasës, në këtë formë të punës mësimore mbahet parasysh edhe pozita e nxënësit mbi-mesatar, por edhe e atyre që ngecin në mësim për shkaqe të veçanta.

Meqë gjatë punës së rregullt mësimore është vështirë të bëhet angazhimi i veçantë i këtyre nxënësve, mësimitdhënësi përdorë edhe forma plotësuese mësimore ose jashtë mësimore. (Zylfiu,

2001, pp. 187-188).Një nga dobësitë më karakteristike të formës kolektive të mësimi është mungesa e komunikimit të ndërsjellë të vetë nxënësve gjatë punës mësimore, meqë komunikimi i tyre zhvillohet vetëm në relacion me mësimdhënësin. Mësimdhënësi gjatë punës mësimore duhet t'u mundësoj nxënësve të zhvillojë komunikim ndërmjet tyre përmes pyetjeve. Një variant i formës frontale ose kolektive, që përdoret e që është popullarizuar sidomos në arsimin e lartë, është puna mësimore masive, e cila organizohet kryesisht në punën mësimore me të rritur, ku mund të përfshihet një auditor më i gjerë.(Zylfiu, 2001, p. 189)

5.1.1Format e punës mësimore në grupe

Organizimi i punës mësimore në grupe zhvillohet në bazë të parimit të “grupit të lire” dhe të zgjedhjes së lire të punës. Në punë grupore, nxënësve u mundësohet socializmi i plotë në mësim dhe mundësia për një përgatitje më të mire për jetën. Duke shfaqur aspektet intelektual të angazhimit në punë grupore, nxënësit zbulojnë të vërtetat shkencore, të cilat ndikojnë në formimin e tyre intelektual dhe social. (Zylfiu, 2011).

Një ndër faktorët me rëndësi në organizimin me sukses të formës mësimore në grupe janë përgatitjet paraprake që duhet bërë. Një problem të veçantë në këtë formacion social të punës mësimore paraqet çështja e formimit të grupeve. Grupet optimal në këtë formë të organizimit të punës mësimore mund të jenë prej 3-6 nxënës të moshës parashkollore 3-6 nxënës të moshës së caktuar shkollore. Formimi dhe madhësia e grupeve nuk mund të jetë çështje e rastit, por jo edhe imponuese, sepse pasojat mund të jenë të shumta. Kur flasim për formimin e grupeve gjithnjë duket të kihet parasysh karakteri demokratik i punës dhe i përcaktimit të çdo pjesëmarrësi të grupit të punës.

Veprimtaria e çdo grupi punues është e pavarur, por zhvillohet kryesisht nën udhëheqjen dhe me ndihmën e mësimdhënësit që nga faza përgatitore, deri te kontrollimi i rezultateve të punës. Në zhvillimin e veprimtarive të punës në grupe, udhëheqësi i grupit do të jetë njëkohësisht edhe bartës i përgjegjësisë lidhur me vendosjen e raporteve demokratike dhe në angazhimin kolektiv në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të grupit.

Efektet pedagogjike të punës mësimore në grupe, pos faktorëve subjektive, varen në masë të konsiderueshme edhe nga kushtet objektive. Me qëllim që komunikimet e ndërsjella dhe karakteri

interaktiv i punës në grupe të zhvillohen sa më mire, duhet të theksohet se e tërë kjo varet edhe nga pozita e çdo individi në grup. Karakteri interaktiv i mësimit ka për qëllim që rolin dominues të mësimeve ta zëvendësojë me elemente bashkëveprimi mes nxënësve, me krijimin e një ekologjike në klasë, duke synuar ngritjen pedagogjike në klasë, duke synuar ngritjen e efikasitetit të punës mësimore.(Zylfiu, 2011, pp. 193-201).

5.1.2 Forma e punës mësimore në çifte

Sikurse edhe format tjera të punës mësimore, ashtu edhe në këtë formë, efikasiteti i veprimtarisë edukative dhe arsimore varet nga përgatitja paraprake e mësimeve dhe e nxënësve. Puna mësimore e çifteve zhvillohet kryesisht në mënyrë të pavarur por edhe me ndihmën dhe udhëzimet e mësimeve.(Zylfiu, 2011, p. 203).

Puna në çifte ka disa veçori specifike dhe positive që duhet të mbahen parasysh dhe ato janë:

- a)Ndikimi pozitiv i partnerit mbi partnerin,
- b)Zhvillimi i shprehive të punës,
- c)Formimi i përgjegjësisë ndaj obligimeve dhe detyrave,
- d)Angazhimi për zbulimin e metodave përkatëse të punës,
- e)Mundësia për krahasim dhe vetëkorrigjim,
- f)Mënjanimi i dukurive të egocentrizmit dhe egoizmit,
- g)Aftësimi për bashkëpunim,
- h)Zhvillimi i punës sipas ritmeve individuale,

Për realizimin e punës mësimore në çifte, si modalitete didaktike të organizimit kryesisht aplikohen këto forma:

1. Puna instruktive, kur partneri mësohet nga partneri më i përgatitur dhe më i mire në mësim.
2. Të mësuarit kooperativë zhvillohet duke u ndihmuar reciprokisht gjatë punës.
3. Të mësuarit individual zhvillohet me qëllim të përgatitjes për punë kooperative dhe për veprimtari të përsëritjes, ushtrimeve etj.(Zylfiu, 2011, p. 204).

5.1.3. Forma e organizimit të punës në mënyrë individuale

Forma e punës individuale në mësim, me elementet e saj të komunikimit direkt paraqet një nga kërkesat parësore të organizimit bashkëkohorë të punës mësimore. Kjo formë e punës mësimore quhet edhe formë e diferencuar. Mësimi individual kërkon angazhime të veçanta të punës së mësimdhënësit të personelit tjetër mësimor.

Mësimi individual është i kushtëzuar edhe nga disa faktorë që kanë të bëjnë me vetë nxënësit, si subjekti më i rëndësishëm në organizimin e punës mësimore, me qëllim potencialet mësimore të nxënësve të mos i nënshtrohen vlerës mesatare të imagjinuar të klasës dhe të mos shuhen aftësitë kreative. Me anë të punës mësimore, nxënësi, si subjekt mësimor, bëhet përgjegjës jo vetëm për kryerjen e detyrave, por edhe për mënyrën e zgjidhjes së problemeve të shtruara dhe të rezultateve.

Informimi i drejtë për qëllimet dhe detyrat e punës e mobilizon nxënësin në një shkallë më të lartë të aktivitetit, duke nxitur motivet për punë dhe duke zgjuar interesimin e tij për të arritur rezultate sa më të mira dhe sa më të suksesshme. (Zylfiu, 2011)

5.2. Mendimi kritik

Detyrë e shkollës sot është që t'i aftësojë nxënësit në kërkimin e informacionit si dhe përdorimin e duhur të tij. Nxënësit duhet të mendojnë në mënyrë të tillë që të bëjnë zbulime për veten e tyre, të jenë kreative dhe sa më origjinale, të shprehin qartë dhe pa derëza atë që ata e mendojnë. Kjo arrihet vetëm duke zhvilluar mësimdhënien dhe të nxënit ndërveprues në kuadër të mendimit kritik. Mendimi kritik është diçka që kultivohet. Të menduarit kritik, konsiderohet shtylla bazë e mësimdhënies bashkëkohore, mbi të cilin parashihet realizimi i veprimtarisë edukativ-mësimore. Të menduarit kritik është një formë e re e mësimdhënies dhe të nxënit bashkëkohor që zbatohet në të gjitha nivelet e mësimin. Të menduarit është një proces i ngjashëm me të lexuarit, të shkruarit të folurit apo të dëgjuarit. (KEC, 1998).

Ai është një proces aktiv, ndërveprues, i cili përfshin të menduarit për diçka të vërtetë. Ai nuk është diçka që mësohet jashtë përmbajtjes. Mendimi kritik nuk mësohet në mënyrën më të mirë, kur ndahet nga konteksti i përgjithshëm i përmbajtjes shkollore apo jetës së përditshme.

Në shkollë, të nxënit për të menduar në mënyrë kritike, më mire duke e provuar si një rrugë të përvetësimit të përmbajtjes, si diçka që është pjesë e rezultateve të pritshme.(Musai, 2003).

Të menduarit kritik është të menduarit e nivelit të lartë. Nxënësi fillon të mendojë në mënyrë kritike atëherë kur nis të vlerësojë, të hulumtojë dhe të krijojë ide të reja. Të menduarit kritik arrihet duke njohur dhe duke zbatuar praktikisht të gjitha metodat, teknikat ndërvepruese që e ndihmojnë këtë proces të ndërlikuar.(Ismaili, 2012). Lambright pohon se, "nëse dëshiron të mësoni të menduarit kritik ju sugjerojmë të krijoni një ushtrim që kërkon nxënësit të praktikojnë të menduarit kritik dhe njëkohësisht të demonstrojnë progresin e tyre në arritje atë aftësi komplekse. (Lambright, 1995, pp. 30-34).Nxënësit që mendojnë në mënyrë kritike, zakonisht janë entuziastë për të mësuar. Nxënësit aftësohen të përballojnë sfidat dhe shohin mundësi për të nxënë edhe në detyrat më të vështira.(Temple, 2006).Nëse arrijmë ta realizojmë këtë qëllim në rrethin stimulus në të cilin fëmijët dëshirojnë të mësojnë, sepse ajo që u ofrohet në klasë është interesante dhe thelbësore, atëherë njohuritë dhe shkathtësitë e arritura do t'i ruajnë gjatë tërë jetës.(Miller, 2005).Mendimi kritik nuk rrjedh vetëm prej mësimdhënies, pormendimi kritik zhvillohet më mirë kur rrjedh nga vet kureshtja e nxënësve, me sfida të vërteta për të cilat nxënësit janë vetë të interesuar. Mendimi kritik është proces njohës veprues dhe ndërveprues në disa nivele të të menduarit.(Musai, 2003).

Të menduarit është një proces i ngjashëm me të lexuarit, të shkruarit, të folurit apo të dëgjuarit. Mendimi kritik është një rezultat; aj është një pikë në procesin e të menduarit, me anë të të cilit çdo njeri mendon në mënyrë kritike, si një rrugë natyrore e ndërveprimit me idetë dhe informacionin; ai është një proces aktiv, që kërkohet të zhvillohet me qëllim ose ndodh rastësisht, i cili në mënyrë të qëndrueshme e bën nxënësin të kontrollojë informacionin, dhe kështu ai mund të përballojë një sfidë; të përfshijë, të përshtatë apo të shpërndajë informacionin. (Steele&Meredith&Temple, 1998).

Të menduarit kritik ka katër komponentë kryesorë:

Aplikimi - përdorimi i dijeve dhe të kuptuarit për të përfunduar detyrat.

Analiza - ndarja e informacionit apo gjërave në komponentë.

Sinteza - integrimi dhe kombinimi i burimeve të ndryshme të informacionit

Vlerësimi - matja e vlerësimit, meritës, ose çdo informacioni me vlerë.

Taksonomia kognitiviste e Benjamin Samuel Bloom, vlerësimin e paraqet si sinonim të të menduarit kritik. Mendimi kritik si koncept daton që nga koha e Sokratit. “Të pyeturit Sokratik” njihet si strategji me e mire e mësimdhënies me baze mendimin kritik.(Sanders, 1989).Mund të përfundojmë se mendimi kritik bazohet në aftësinë për të gjykuar dhe për të reflektuar për idetë tona dhe të të tjerëve. Kjo do të thotë se të menduarit kritik nuk ka të bëjë me atë që mendojmë, por me mënyrën si mendojmë.(Ismaili, 2012).

5.3.Struktura për mësimdhënie dhe për zhvillimin e të të menduarit kritik në gjuhë-ERR

Për të zhvilluar procesin e mësimdhënies dhe nxënies, për të zhvilluar njohuritë, shkathhtësitë dhe dituritë dhe për të rritur nivelin e dijës së nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe në shkollë, duhet të përdoren të gjitha metodat, mënyrat, strategjitë, procedimi i objektivave dhe rezultatit si proces i nxënies së mësimt. Organizimi i orës mësimore sipas strukturës ERR është treguar si mjaftë e suksesshme në përgatitjen e nxënësve të cilët mendojnë në mënyrë kritike. Çdo mësim i gjuhës, sipas mënyrës së vet, përbën një shembull të mësimdhënies, që ne e kemi quajtur Evokim-Realizim kuptimi-Reflektim.

Evokimi-është fazë mësimi në të cilën nxënësve u kërkohet të mendojnë lidhur me një temë apo njësi mësimore, që tashmë nxënësit supozohet se dinë të shtrojnë pyetje lidhur me të dhe të caktojnë qëllimet e të nxënësve. Evokimi është pjesë e mësimt, ku mësimdhënësi synon të risjellë (rikujtojë) njohuritë që kanë marrë nxënësit rreth një teme të caktuar që do ta shtjellojë më pas. Kjo etapë e orës ka rëndësi për të njohur dijet e nxënësve dhe rikujtimet e asaj çka di rreth temës së planifikuar, në mënyrë që mësimdhënësi të ndërtojë aktivitetet dhe veprimtaritë gjatë orës së mësimt. Që nxënësit të përvetësojnë në mënyrë të logjikshme, të arsyetuara njohuritë e reja, duhet që ato të përfshihen gjallërisht në procesin e të nxënësve.

Faza e evokimit shërben:

- ❖ Për t'i nxitur nxënësit të sjellin në mend njohuritë ekzistuese që zotërojnë;
- ❖ Për të kryer vlerësim sa më të plotë në lidhje me atëçka dine nxënësit,përfshirë dhe konceptet e gabuara;
- ❖ Për të përcaktuar qëllimet e nxënies;
- ❖ Për të përqendruar vëmendjen tek tema apo njësia mësimore;
- ❖ Për të fituar një kontekst në të cilën do të vendosen idetë e reja;(Rraçi&Kuqi, 2017).

Realizimi kuptimi- kjo është faze kur lexuesi vjen në kontakt me informacionin apo idetë e reja. Ky kontakt mund të marrë formën e tekstit të leximit. Detyra thelbësore e fazës së realizimit të kuptimit, është, së pari, ta mbajë nxënësin të përfshirë, të ruajë interesin për nxënie. Detyra tjetër është të mbështes përpjekjet e nxënësve për të kontrolluar të kuptuarit. Nxënësit e suksesshëm, lexuesit frytdhënës i kontrollojnë të kuptuarit e tyre si një informacion të ri. Nxënësit pasivë vetëm kalojnë sipër gabimeve në arsyetim, të pavetëdijshëm, keqkuptimet apo mungesat e ndryshme të informacionit.(Trëndafili, 2008).Nxënësit përmes të nxënit aktiv kontrollojnë hap pas hapi përvetësimin e njohurive dhe përfitimin e kuptimit mbi tekstin si një informacion të ri.(Rraçi& Kuqi, 2017).

